



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	Nr.Br.No.	01, 205
DATUM	14. 03. 2024	PRISHTINË - A

KGJK.nr.61/2024  
Datë: 7 mars 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, bazuar në nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 1, pikat 1.12, 1.13, 1.16 dhe 1.17 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 42 të Ligjit mbi Procedurën e Përmbarimore (Nr. 04/L-139), në takimin e 322-të, të mbajtur me datë 7 mars 2024, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Tërhiqen të gjitha propozimet për përmbarim ku kreditorë janë gjykatat, në lëndët në të cilat kërkuesat për përmbarim kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe të paushallit gjyqësor, duke përfshirë periudhën kohore deri me datë 31 dhjetor 2020, por që tërheqja e propozimeve të bëhet me kushtet si në vijim:
  1. Të jenë ndërmarrë veprime nga ana e gjykatës për ekzekutimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor;
  2. Të jetë konstatuar se mos ekzekutimi i këtyre lëndëve është rezultat i mungesës së pasurisë së debitorit (mjetet e mundshme për zbatimin e këtyre vendimeve);
  3. Tërheqja e propozimeve në asnjë rast nuk mund të bëhet nga ana e gjykatës kur është ekzekutuar vendimi mbi shpenzimet e procedurës por jo edhe paushalli gjyqësor, pavarësisht vitit.
- II. Procesi të monitorohet nga kryetarët dhe administratorët e gjykatave me një mbikëqyrje nga KGJK-ja përmes njësive përkatëse.
- III. Kërkohet nga menaxhmenti i gjykatave të themelojnë komisionin për identifikimin e lëndëve dhe kushteve për tërheqje nga procedurat e përmbarimit në rastin e shpenzimeve dhe paushallit gjyqësor dhe lista e krijuar t'i dërgohet KGJK-së për konfirmim, në afat prej 3 (tre) muaj, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi me date 7 mars 2024.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas miratimit të Planit të Veprimit lidhur me Ekzekutimin e Lëndëve në Gjykata 2024-2025, ka ndërmarr të gjitha veprimet lidhur me realizimin e të njëjtit, ku ndër të tjerash ka kërkuar nga administratorët e gjykatave, informacione sa i përket gjendjes së lëndëve

përmbarimore lidhur me shpenzimet procedurës dhe të paushallit gjyqësor, ku kreditorë janë gjykatat.

Nga informacionet e pranuara, rezulton se në gjykata ekziston një numër i madh i lëndëve të kësaj natyre, të cilat përkundër faktit që gjykatat kanë ndërmarr me kohë të gjitha veprimet lidhur me ekzekutimin e tyre, të njëjtat nuk janë ekzekutuar për shkaqe apo rrethana të cilat nuk varen nga gjykatat.

KGJK, në takimin e mbajtur, pas shqyrtimit të gjendjes ekzistuese lidhur më lëndët e kësaj natyre, e vlerësoi si të domosdoshme që tërheqja e propozimeve për përmbarim të bëhet vetëm nëse plotësohen 3 (tre) kushtet e caktuara në paragrafin I të vendimit, duke përshirë edhe periudhën kohore sa i përket lëndëve në fjalë, me ç'rast do të konsiderohej se janë konsumuar të gjitha mundësitë për ekzekutimin e tyre.

Po ashtu, duke parë rëndësinë e kësaj çështjeje, KGJK e vlerësoi si të domosdoshme që i tërë procesi të monitorohet nga struktura menaxheriale e gjykatës, me një mbikëqyrje nga komisionet dhe njësitat përkatëse në KGJK, si dhe përcaktoj edhe modalitetet sa i përket realizmit të këtij procesi, me ç'rast kërkoi nga menaxhmenti i gjykatave që të themeloj një komision për identifikimin e lëndëve dhe kushteve për tërheqje, e cila listë pastaj do të konfirmohet nga KGJK.

Këshilli, duke u bazuar në mandatin e vet kushtetues dhe ligjor, ku ndër të tjera shënon vendos edhe për ngarkesën me lëndë të gjykatave, duke siguruar funksionimin efikas të tyre, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,

Kryesues i Këshilli Gjyqësor të Kosovës



*Kopja e vendimit i dërgohet:*

- Gjykatave Themelore dhe degëve të tyre;
- Sekretariatit të KGJK-së dhe Arkivit.